

# POLICY BRIEFS MACEDONIA



Konrad  
Adenauer  
Stiftung

## REPUBLIKA E MAQEDONISË DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE - JURIDIKE PËR LIRINË E FESË

Maj 2015

[www.kas.de/mazedonien](http://www.kas.de/mazedonien)

Në këtë punim trajtohen standardet ndërkombëtare-juridike për lirinë e fesë, përmes një vështrimi hyrës përkatës të cilit i ndërlidhet një analizë e dokumenteve relevante të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës, dokumente këto të aprovuara nga Republika e Maqedonisë. Nga teksti mund të perceptohet se shteti ynë në mënyrë konsekuente i respekton standardet e këtilla, megjithatë është e nevojshme që fokusi institucional të vazhdojë në drejtim të tejkalimit të sfidave të tjera të një pjese të kësaj fushe jashtëzakonisht dinamike, në përputhje me normat dhe frymën e standardeve të analizuara ndërkombëtare. Sfidat e këtilla kryesisht kanë të bëjnë me ndërtimin e konsensusit shtetëror në lidhje me “kufijtë e shekullarizmit maqedonas” i cili, nga ana tjetër, përfshin një sërë çështjesh komplekse që kanë të bëjnë me shkallën e prezencës së religjionit në politikë dhe në institucione, por edhe në arsim, shëndetësi, kulturë dhe në përgjithësi në jetën publike të qytetarëve të cilët janë të lirë të vendosin nëse dhe cilës fe do t’i përkasin, ta ndryshojnë fenë dhe gjithsesi, qoftë vet ose në bashkësi me të tjerët, ta praktikojnë fenë e tyre.

**Doc. Dr. Aleksandar Spasenovski**  
**Fakulteti Juridik “Justiniani i Parë”**  
**Universiteti “Shën Cirili e Metodi”**

## LISTA E SHKURTESAVE

1. RM – Republika e Maqedonisë
2. OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara
3. KiE – Këshilli i Evropës
4. BE – Bashkimi Evropian
5. SHBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës
6. UDHR – Deklarata Universale për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut
7. KEDNJ – Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
8. NATO –Aleanca e Traktatit të Atlantikut Verior

## VËSHTRIME HYRËSE

Ideja se të gjitha qeniet njerëzore janë të barabarta dhe se kanë të drejtë plotësisht ta realizojnë lirinë e besimit fetar fiton dinamikë të përforcuar fillimisht me zhvillimin e demokracisë përfaqësuese në dritën e etablimentit të mëtutjeshëm të bindjes për rëndësinë fundamentale të dinjitetit të personalitetit njerëzor<sup>1</sup>. Kundrejt këtij fakti, në pjesën më të madhe të historisë njerëzore, format e pushtetit shtetëror kryesisht kanë qenë monarkiste, ndërsa ndonjëherë madje edhe totalitare, me ç'rast bindja dominante e sunduesve ka qenë se religjioni i përbashkët është bazë për një shoqëri të qëndrueshme, e që konsiston me qëllimin e tyre kryesor.<sup>2</sup> Nisur nga kjo, imponimi i një religjioni të caktuar nga ana e shtetit ndaj nënshtetasve e ka nënkuptuar njëherën nga format më karakteristike të veprimit, e që nënkuptohet se nuk ka mundur të kalojë pa përdorimin e forcës<sup>3</sup>. Së këtejmi, imponohet edhe konstatimi se e kaluara politike e popujve dhe shteteve është përplot me ngjarje të jotolerancës fetare, luftërave fetare ose inkuizicioneve<sup>4</sup>, për çka edhe përgjigjja e shteteve të Evropës Perëndimore është **vendosja e parimit demokratik të lirisë fetare me të cilin qeveritë e shpallin neutralitetin e tyre sa u përket çështjeve fetare, duke ia lënë çdo qytetari të vendos vet, sa u përket bindjeve të tij fetare**<sup>5</sup>. Pavarësisht zhvillimit të këtyre të ndërgjegjes politike, edhe sot e kësaj dite, mbrojtja e lirive dhe të drejtave fetare është një detyrë jashtëzakonisht serioze për vet shtetet, meqë realizimi i tyre nënkupton **krijimin e rregullave koherente ligjore të cilat do të mundësojnë një balancë në realizimin e të drejtave dhe detyrave si të pjesëtarëve të fesë dominante, ashtu edhe të pjesëtarëve të fesë minoritare dhe të atyre qytetarëve të cilët nuk kanë ndjenja dhe përkatësi fetare**<sup>6</sup>. Me këtë sfidë përballen edhe organizatat ndërkombëtare, duke bërë përpjekje që në mënyrë plotësuese t'i ngritin standardet që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, pjesë esenciale e të cilave është liria e besimit fetar<sup>7</sup>.

Republika e Maqedonisë (RM) ndërton një sistem i cili bazohet mbi standardet e njohura civilizuese. Nga ana tjetër, ato shprehjen e tyre juridike e gjejnë në dokumentet e organizatave përkatëse ndërkombëtare qeveritare të njohura nga shteti ynë. Në këtë drejtim, dokumentet përkatëse të miratuara nga Kombet e Bashkuara (KB) dhe

<sup>1</sup> Për zhvillimin historik të botëkuptimit të të drejtave të njeriut, shih: Biran Tierney, *The Idea of Natural Rights: Studies on Natural Rights, Natural Law and Church Law 1150-1625*, 1997.

<sup>2</sup> Darek H. Davis, *The Evolution of Religious Freedom as a Unoversal Human Right: Examing the Role of the 1981 United Nation Declaration on the Eliimination of All Forms of Intolerance and of Discrimination Based on Religion or Belief*, Brigham Young University Law Review, 2002, f: 220.

<sup>3</sup> Shih: Oded Haklai, *Religious-Nationalist Mobilization and State Penetration Lessons From Jewish Settlers' Activism in Israel and the West Bank*, Comparative Political Studies nr.: 6, Sage Publications, qershor 2007, f.: 713-730.

<sup>4</sup> Shih: AlexanderKyrlezhev, *RelationshipsBetweenHumanRightsConceptAndReligiousValues*, Religion in EasternEuropeбр.: 1, shkurt 2007, f.: 41-47.

<sup>5</sup> Shih PetervanderVeer dhe HartmutLehmann, *NationandReligionPerspectiveson EuropeandAsia*, Princeton University Press, PrincetonNew Jersey, 1999 dhe Darek H. Davis, *The Evolution of Religious Freedom as a Unoversal Human Right: Examing the Role of the 1981 United Nation Declaration on the Eliimination of All Forms of Intolerance and of Discrimination Based on Religion or Belief*, op.cit.

<sup>6</sup> Shih: James F. Harris, *Religion and Liberal Democracy*, The Humanist, maj-qershor 2006, f.: 26-30 dhe Brice Dickson, *The United Nations and the Freedom of Religion*, International and Comparative Law Quarterly, 1995, f.: 327.

<sup>7</sup> Shih: Daniel Philpott, *Religious Freedom and the Undoing of the Westphalian State*, Michigan Journal of International Law, vera e vitit 2004, f.: 981-998; A. Raymond Randolph, *Spreading Democracy*, Northwestern University Law Review nr.: 1, 2008, f.: 431-432 dhe Louis René Beres, *Religious Extremism and International Legal Norms: Perfidy, Preemption, and Irrationality*, Case Western Reserve Journal of International Law nr.: 39, f.: 709-730.

nga Këshilli i Evropës (KiE), si organizata në të cilat aderohet RM, në përputhje me normat e Kushtetutës janë pjesë të rendit tonë të brendshëm juridik.

Duke e pasur parasysh këtë që u tha më lart, përgjigjet në pyetjet që kanë të bëjnë me lirinë e fesë, shpalosen në katër tërësi tematike të këtij punimi, me ç'rast në të parën, me titullin: "Pasqyra teorike-historike dhe klasifikimet" prezantohet vështrimi i zhvillimit të ideve lidhur me lirinë e fesë gjatë historisë. Në tërësinë e dytë, me titull: "Kombet e Bashkuara dhe liria e fesë" pason analiza normative e domethënies dhe përfshirjes së lirisë së fesë në dokumentet e organizatës botërore, ndërkaq në tërësinë e tretë, me titull: "Këshilli i Evropës dhe liria e fesë" është prezantuar një analizë përkatëse, sikurse edhe në rastin paraprak në lidhje me organizatën e përmendur ndërkombëtare. Në themelin e informatave të prezantuara, në tërësinë e katërt tematike, me titull: "Pikëpamje përfundimtare" janë prezantuar informata me të cilat përcaktohet korniza dhe përfshirja e lirisë së fesë në RM.

Ky punim është vazhdimësi e dy hulumtimeve paraprake<sup>8</sup> të cilët kanë të bëjmë me modelin maqedonas të shekullarizmit, ndërkaq me mbështetje nga përfaqësia e Fondacionit "Konrad Adenauer" në Shkup.

---

<sup>8</sup> Shih: *Partitë politike dhe kufijtë e shekullarizmit në Republikën e Maqedonisë*, Fondacioni "Konrad Adenauer", Policy Brief, Shkup, 2014 dhe *Ndikimi i komuniteteve fetare mbi institucionet dhe politikën e Republikës së Maqedonisë*, Fondacioni "Konrad Adenauer", Policy Brief, Shkup, 2015.

# 1. PASQYRA TEORIKE-HISTORIKE DHE KLASIFIKIMET

Ideja për tolerancë midis njerëzve është e vjetër sa edhe vet njerëzimi<sup>9</sup>. E njëjta buron nga vlerat më të thella të natyrës njerëzore dhe si e tillë është përcaktuar dhe mbindërtuar gjatë historisë përmes mësimëve të religjioneve të mëdha, por edhe përmes krijimtarisë të teoricienëve dhe mendimtarëve të ndryshëm<sup>10</sup>.

Sa u përket feve të mëdha, si shembull do t'i marrim krishterimin dhe islamin, të cilët predikojnë respektim të ndërsjellë dhe mirëkuptim midis njerëzve. Në këtë kontekst, në Librin e Shenjtë të Dhiatës së Vjetër dhe të Re (Bibla), i cili është bazë e fesë krishtere, thuhet:

“Nëse një i huaj vendoset në vendin tuaj, mos e shtypni. I huaji, i cili banon me ju, le t’ju bëhet si bashkëkombës; duaje si vetveten; sepse edhe ju keni qenë të huaj në Tokën egjiptiane. Unë Jam Perëndia, Zoti Juaj!”<sup>11</sup>.

Ndërkaq, Profeti Muhamed, i cili është themelues i islamit po ashtu ka pasur qëndrime të tij sa i përket lirisë së besimit fetar si e drejtë themelore e të gjithë njerëzve. Ai thotë:

“Deri te të krishterët e Najran-it dhe deri te territoret fqinje – paqja e Zotit ka të bëjë edhe me jetët e tyre, fenë e tyre, tokën e tyre dhe pronën e tyre...”<sup>12</sup>.

Duke e pasur parasysh këtë bazë, të vendosur nga mësimet fetare e cila, në njëfarë mënyre, buron nga natyra njerëzore, ndërliidhen pozitat e ndryshme të një numri të madh të teoricienëve gjatë historisë. Në këtë kontekst, mjetin kryesor për zhvillimin e idesë për të drejtat dhe liritë e njeriut e gjejmë në përpjekjet e tyre për strukturimin e shoqërisë njerëzore sipas – siç konstatohet shpesh – **parimet më të larta supreme të universit, të cilët në teori njihen me emrin “të drejta natyrore”**. Përkatësisht, ithtarët e kësaj ideje kanë besuar se ekzistojnë vlera supreme, të cilat janë mbi të gjithë dhe të cilat në mënyrë të barabartë mund të aplikohen kudo në botë, pavarësisht përkatësisë racore, fetare, sociale ose përkatësisë tjetër të njerëzve. Kjo është kështu meqë është besuar se të drejtat e njeriut janë produkt të Zotit, ndërsa qëllimi i çdo njeriu është të jetojë në harmoni me Të<sup>13</sup>. Themelet e mënyrës së këtillë të vendosjes së botëkuptimeve për natyrën e të drejtave të njerëzve, mund t’i gjejmë, përveç se tek mësimet fetare, dhe paraprakisht në histori, në tekstet e filozofëve antikë, siç janë **Sokrati, Platoni** ose **Aristoteli**<sup>14</sup>. Në kontekst të kësaj që u tha më lart, gjithashtu, shkenca historike ka vënë në dukje më shumë shembuj praktikë kur shtetet, në kuadër të territoreve të tyre, u kanë ofruar garanci feve minoritare për

<sup>9</sup> Shih: Rex Ahdar dhe Ian Leigh, *Religious Freedom in the Liberal State*, Oxford University Press, 2005.

<sup>10</sup> Shih: Theo C. Van Boven, *Religious Liberty in the Context of Human Rights*, *The Ecumenical Review*, f.: 345-355 dhe Michael W. McConnell, *Religious Freedom, Separation of Powers, and the Reversal of Roles*, *Brigham Young University Law Review*, 2001, f.: 611-618.

<sup>11</sup> Libri i Shenjtë i Dhiatës së Vjetër dhe të Re (Bibla), op.cit. Libri i Levit 19:33-34.

<sup>12</sup> Shih: Arcort Krishnaswami, *Study of Discrimination in the Matter of Religious Rights and Practices*, United Nations, 1960, f.: 2.

<sup>13</sup> Darek H. Davis, *The Evolution of Religious Freedom as a Universal Human Right: Examining the Role of the 1981 United Nation Declaration on the Elimination of All Forms of Intolerance and of Discrimination Based on Religion or Belief*, op.cit.

<sup>14</sup> Shih: *The Encyclopedia of Political Science*, op.cit., f.: 695-698.

realizimin e të drejtave dhe lirive fetare deri në njëfarë shkalle. Kështu, për shembull, që nga koha e **Perandorisë Romake**, janë toleruar forma të ndryshme të praktikimit fetar të nënshtetasve derisa ato nuk kanë qenë në kundërshtim me rregullat e përgjithshme të Perandorisë<sup>15</sup>.

**Mesjeta** është ajo pjesë e historisë njerëzore që mund të emërohet si periudhë e teorisë së të drejtave natyrore. Në këtë periudhë, të drejtat natyrore paraqesin shtesë të të drejtës kanunore (kishtare) dhe të drejtës qytetare, përkatësisht besoj se njeriu nuk mund ta krijojë ligjin, por vetëm mund ta zbulojë<sup>16</sup>. Në këtë kuptim, përkundër besimeve të përcaktuara të këtilla, megjithatë njerëzit në këtë periudhë kanë shumë pak të drejta inhereente, ndërsa në vend të kësaj ballafaqohen me numër të madh të detyrave, me realizimin e të cilave besoj se ata punojnë për realizimin interesit më të madh të Zotit, të kishës, perandorisë, mbretit ose të pronarit feudal<sup>17</sup>. Me kalimin e kohës, ashtu siç fillojnë të fundosen institucionet mesjetare, ndërsa në vendin e tyre vijnë kombet-shtete, njerëzit fillojnë të fitojnë autonomi më të madhe personale. Ky proces i kalimit të konceptit abstrakt të të drejtave natyrore në ligje dhe përmes tyre të implementohet në praktikë, ka qenë një proces jashtëzakonisht i ngadalshëm dhe gradual<sup>18</sup>.

Teoricieni i cili mbase në mënyrën më të mirë të mundshme i ka artikuluar idetë e përmendura është **Xhon Lok**. Qëndrimet e tij më vonë bëhen bazë për një numër të madh të dokumenteve bartëse kushtetuese-juridike. Në këtë aspekt, me rëndësi të veçantë janë:

- ❖ **Së pari**, Deklarata për Pavarësinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) nga viti 1776, në të cilën në pasusin e dytë është përcaktuar, si vijon:

"Të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë dhe nga ana e Krijuesit të tyre u janë dhënë të drejta të caktuara të patjetërsueshme në mesin e të cilave është jeta, liria dhe kërkimi i lumturisë"<sup>19</sup>.

- ❖ **Së dyti**, Deklarata Franceze për të Drejta nga viti 1789, në të cilën në nenin 10 thuhet:

"Askush nuk mund të merret në përgjegjësi për mendimin e tij, madje edhe për atë fetar, nëse sjellja e këtillë nuk e prish rendin publik dhe proceset e vendosura me ligj"<sup>20</sup>.

Lok-u beson se të gjitha qeniet njerëzore posedojnë të drejta elementare, ndërsa qeveria e ka për detyrë që të njëjtat t'i mbrojë. Në kontekstin e lirisë së fesë, sipas Lok-ut, **roli i qeverisë është t'i mbrojë njerëzit që ta praktikojnë fenë e tyre**

<sup>15</sup> Jay A. Sigler, *Minoritie Rights: A Comparative Analysis*, Greenwood Press, 1983, f.: 41

<sup>16</sup> Për zhvillimin e së drejtës në Mesjetë, shih: Fritz Kern, *The Lack of Legislative Power, The Midle Ages: Readings in Medieval History*, 1970.

<sup>17</sup> Darek H. Davis, *The Evolution of Religious Freedom as a Unoversal Human Right: Examing the Role of the 1981 United Nation Declaration on the Elimination of All Forms of Intolerance and of Discrimination Based on Religion or Belief*, op.cit., f.: 221.

<sup>18</sup> Arcort Krishnaswami, *Study of Discrimination in the Matter of Religious Rights and Practicies*, op.cit., f.: 4.

<sup>19</sup> *Declaration of Independence*, (archives.gov), 7.11.2011.

<sup>20</sup> *Declaration of the Rights of Man and of the Citizen*, (hrcr.org), 7.11.2011.

**në atë mënyrë për të cilën ata mendojnë se vetëm ajo është e drejtë.** Në këtë aspekt, Lok-u thotë:

“Kujdesi për shpirtin e secilit person dhe për gjërat në parajsë (...) duhet t’i lihet secilit personi individualisht”<sup>21</sup>.

Qëndrimet e këtilla lidhur me lirinë e fesë, Lok-u i ndërton meqë ka qenë i bindur se koncepti i imponimit të një religjioni të caktuar, nga ana e shtetit, në të kaluarën shpeshherë ka rezultuar me probleme dhe jo me zgjidhje, përkatësisht vrasja e miliona njerëzve në emër të një religjioni të caktuar ndër shekuj ndodh meqë qeveritë kanë pasur ndikim tepër të madh mbi religjionin dhe kanë tentuar ta imponojnë këndvështrimin e tyre lidhur me çështjet fetare dhe në këtë mënyrë kanë rënë në konfrontim me njerëzit e tjerë dhe me religjionet e tjera<sup>22</sup>. Për këtë shkak, sipas tij, në mënyrë që shoqëritë të mbijetojnë duhet **“t’i lënë njerëzit që ta zgjedhin fenë e tyre, përkatësisht kapitulli i historisë njerëzore për unitet midis kishës dhe shtetit përfundimisht duhet të mbyllet”**<sup>23</sup>.

Baza teorike e vendosur në këtë mënyrë deri në fillim të shekullit 20, lirinë e besimit fetar e përcakton kryesisht në dokumentet ndërkombëtare edhe atë për komunitetet minoritare fetare<sup>24</sup>. Në këtë aspekt, me rëndësi të veçantë janë:

- ❖ **Së pari, Traktati i Paqes i Vestfalisë nga viti 1648**, me të cilin i vihet fund luftës tridhjetëvjeçare. Me të garantohen të drejta të caktuara të protestantëve në shtetet katolike evropiane, si dhe besimtarëve katolik në shtetet të cilat themelojnë kisha të reformuara protestante<sup>25</sup>;
- ❖ **Së dyti, Traktati i Paqes i Berlinit nga viti 1878**, me të cilin shteteve ballkanike (**Bullgarisë, Malit të Zi, Rumanisë dhe Serbisë**) nga fuqitë e atëhershme botërore, u imponohen rregulla sipas të cilave ato detyrohen **që në kuadër të** garancive të tyre ta garantojnë të drejtën e pronësisë, si dhe lirinë e fesë të komuniteteve minoritare<sup>26</sup>;
- ❖ **Së treti, Konferenca e Paqes në Paris nga viti 1919**, pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, me të cilën u imponohet obligimi për respektim, mes tjerash edhe të lirisë së fesë edhe atë si shteteve të cilat pësuan humbje (për shembull: **Austria, Bullgaria ose Turqia**), ashtu edhe shteteve të cilat si rezultat i pushtimeve i zgjeruan kufijtë e tyre (për shembull: **Çekosllovakia, Greqia, Polonia ose Jugosllavia**)<sup>27</sup>.

<sup>21</sup> John Locke, *A Letter Concerning Toleration*, Prometheus Books, 1990.

<sup>22</sup> John Locke, *A Letter Concerning Toleration*, op.cit.

<sup>23</sup> Qëndrimin e këtillë Xhon Lok e shpjegon në fjalitë si vijojnë: Historia jonë moderne angleze na mundëson shembuj të freskët të unioneve të korruptuara në mes të kishës dhe shtetit, në fytyrën e Henrit VIII, Eduardit VI, Marisë dhe Elizabetës – në mënyrë shumë të lehtë dhe të qetë kleri (i kishës) i ndryshonte dekretet e tyre dhe aktet e fesë, format e liturgjive të tyre, konform inklinacioneve të mbretërve dhe mbretëreshave të cekur.” (John Locke, *A Letter Concerning Toleration*, op.cit).

<sup>24</sup> Shih: James E. Wood, *Religious Human Rights and a Democratic State*, Journal of Church and State, f.: 739-765 dhe Bernadette Meyler, *The Limits of Group Rights: Religious Institutions and Religious Minorities in International Law*, St. John’s Journal of Legal Commentary nr.: 2, f.: 535-558.

<sup>25</sup> Benjamin Straumann, *The Peace of Westphalia as a Secular Constitution*, Constellations nr.: 2, 2008.

<sup>26</sup> *Congress of Berlin*, Enciklopedia Britanika, op.cit dhe Daniel Philpott, *Religious Freedom and the Undoing of the Westphalian State*, Michigan Journal of International Law, op.cit.

<sup>27</sup> Shih: Margaret MacMillan, *Paris 1919: Six Months That Changed the World*, Random House Publishing Group, 2007.

Nga ana tjetër, në aspekt të rregullimeve të brendshme-juridike, **SHBA është shteti i parë në Botë i cili në aktin më të lartë juridik, Kushtetutën, e garanton lirinë e fesë**<sup>28</sup>. Ky realitetet është rezultat i qëndrimeve politike të krijuesve të SHBA, të cilët përmes garancive për realizimin e lirë të fesë, kanë pasur shpresa se në territorin e ri nuk do të përballen me probleme fetare dhe me gjykime të cilët kanë qenë karakteristikë e oksidentit të krishterë evropian<sup>29</sup>. **Mënyra me të cilën SHBA e sigurojnë koegzistencën paqësore midis denominacioneve të ndryshme fetare është sanksionuar edhe nga shtetet e tjera në kushtetutat e tyre**<sup>30</sup>. Sot, numri më i madh i shteteve demokratike në kushtetutat e tyre kanë dispozita me të cilat përcaktohen garanci për realizimin e lirisë së fesë<sup>31</sup>.

Sa i përket kësaj çështjeje është me rëndësi themelimi i **Lidhjes së Kombeve** me Konferencën e Paqes në Paris në vitin 1919. Presidenti i SHBA-ve, **Vudrou Uilson**, në këtë drejtim konsideron se çështjet e lirive fetare duhet të paraqesin një nga detyrat kryesore të organizatës së sapoformuar. Ai thotë:

"Duke e njohur faktin se persekutimi fetar dhe jotoleranca janë baza e luftërave [...] duhet të pritët nga të gjitha shtetet, si dhe nga shtetet e reja se nuk do të miratojnë ligje me të cilat do të ndalohej ose do të ndikohet mbi lirinë e fesë..."<sup>32</sup>.

Shpërbërja e Lidhjes së Kombeve dhe kaosi që e përfshiu botën me fillimin e Luftës së Dytë Botërore është shkak për vendosjen e qëndrimit të ri të komunitetit ndërkombëtar në lidhje me të drejtat dhe liritë e njeriut, i cili mbështetet mbi mbrojtjen e përgjithshme dhe universale të të gjitha qenieve njerëzore në të gjitha shtetet<sup>33</sup>. Kjo qasje është mbështetur dhe promovuar nga ana e Presidentit të SHBA-ve **Teodor Ru-zvelt**, i cili në vitin 1941 në fjalimin e tij të njohur "**për katër liritë**" do të deklaroj:

"Secilit person duhet t'i garantohet liria e fjalës, liria e shprehjes, liria e fesë, liria nga lufta si dhe liria nga frika... Liria e fesë është e drejtë e secilit person që t'i lutet Zotit në mënyrë të vet – kudo në botë"<sup>34</sup>.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, në aspektin e çështjes së lirisë së fesë, rëndësi të veçantë ka Deklarata e përbashkët e liderëve të ushtrive aleate antifashiste nga viti 1942, me të cilën mes tjerash konstatohet se:

<sup>28</sup> Shih: Thomas J Curry, *The First Freedoms: Church and State in America to the Passage of the First Amendment*, Oxford University Press, 1986.

<sup>29</sup> Shih: Michael J. Malbin, *Religion and Politics: The Intentions of the Authors of the First Amendment*, American Enterprise Institute for Public Policy Research, 1978 dhe William Lee Miller, *The First Liberty: Religion and the American Republic*, Alfred A. Knopf, 1986.

<sup>30</sup> Shih: Philip Schaff, *Church and State in the United States or the American Idea of Religious Liberty and Its Practical Effect*, G. P. Putnam's Sons, 1888.

<sup>31</sup> Shih: J. Paul Martin, *Religions, Human Rights, and Civil Society: Lessons from the Seventeenth Century for the Twenty-First Century*, Brigham Young University Law Review, 2000, f.: 933-944 dhe Orrin G. Hatch, *Religious Liberty at Home and Abroad: Reflections on Protecting this Fundamental Freedom*, Brigham Young University Law Review, 2001, f.: 413-428.

<sup>32</sup> Brice Dickson, *The United Nations and the Freedom of Religion*, op.cit., f.: 330.

<sup>33</sup> Shih: Daniel Wehrenfennig, *The Human Right of Religious Freedom in International Law*, Peace Review: A Journal of Social Justice nr.: 18, f.: 403-410.

<sup>34</sup> Brice Dickson, *The United Nations and the Freedom of Religion*, op.cit., f.: 331-332.



“Fitorja e plotë ndaj armikut është bazë që të mbrohet [...] liria e fesë dhe të sigurohen të drejtat e njeriut dhe drejtësia”<sup>35</sup>.

Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore fillon një epokë e re në zhvillimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, në këtë kontekst edhe liria e fesë<sup>36</sup>. Përkatësisht, **çështjet e lartpërmendura përfundimisht dalin plotësisht jashtë kornizës së shteteve kombëtare me themelimin e KB-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare rajonale, siç është KiE**<sup>37</sup>.

RM, e cila në këtë periudhë i filloi proceset e ripërtëritjes së shtetit, si pjesë e RSFJ-së, u bë faktor aktiv në këto procese globale në drejtim të ngritjes së standardeve të përgjithshme në lidhje me demokratizimin, pjesë e të cilit janë të drejtat dhe liritë e njeriut, përkatësisht liria e fesë të udhëhequra nga organizatat relevante ndërkombëtare.

## 2. KOMBET E BASHKUARA DHE LIRIA E FESË

KB-ja, si Organizatë Universale Ndërkombëtare, e cila deklarohet si asociacion botëror i qeverive të cilat bashkëpunojnë në fushën e të drejtës ndërkombëtare, sigurisë globale, zhvillimit ekonomik dhe barazisë sociale, u themelua në vitin 1945.

Nga aspekti i temës së këtij punimi, të rëndësishëm janë 5 dokumentet ndërkombëtare të kësaj organizate ndërkombëtare, si vijojnë:

- ❖ **Së pari**, Karta e KB<sup>38</sup>;
- ❖ **Së dyti**, Deklarata Universale për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (UDHR)<sup>39</sup>;
- ❖ **Së treti**, Pakti për të Drejta Civile dhe Politike<sup>40</sup>;
- ❖ **Së katërti**, Deklarata për Eliminimin e të Gjitha Formave të Jotolerancës dhe Diskriminimit në Bazë të Religjionit apo Besimit<sup>41</sup>, si dhe
- ❖ **Së pesti**, Deklarata për të Drejtat e Personave të cilët u Përkasin Minoriteteve Etnike Kombëtare, Fetare dhe Gjuhësore<sup>42</sup>.

<sup>35</sup> ArcortKrishnaswami, *Study of Discrimination in the Matter of Religious Rights and Practicies*, op.cit., f.: 12 dhe Steven K. Green, *Religious Liberty as a Positive and Negative Right*, Albany Law Review nr.: 70, 2007, f.: 1453-1472.

<sup>36</sup> Shih: Lucas Swaine, *The Liberal Conscience: Politics and Principle the World of Religious Pluralism*, Cambridge University Press, 2006.

<sup>37</sup> Shih: Michael J. Perry, *The Morality of Human Rights: A Nonreligious Ground?*, Emory Law Journal nr.: 54, f.: 97-150.

<sup>38</sup> *Charter of the United Nations* (treaties.un.org), 28.6.2012.

<sup>39</sup> *Universal Declaration of Human Rights*, Rezoluta 217 A (III), (un.org), 28.6.2012.

<sup>40</sup> *International Covenant on Civil and Political Rights*, Rezoluta 2200A (XXI), (un.org), 28.6.2012.

<sup>41</sup> *Declaration on the Elimination of All Forms of Intolerance and of Discrimination Based on Religion or Belief*, Rezoluta 36/55, (un.org), 28.6.2012.

<sup>42</sup> *Declaration on the Rights of Persons Belonging to National or Ethnic, Religious and Linguistic Minorities*, Rezoluta 47/135, (un.org), 28.6.2012.

## 2.1. KARTA E KOMBEVE TË BASHKUARA

Karta e KB-së është Marrëveshja ndërkombëtare me të cilën themelohet kjo organizatë botërore<sup>43</sup>. Në Preambulën e këtij Dokumenti, në të cilin përcaktohet motivi i themelimit të tij, është specifikuar se ai mbështetet në përforcimin e të drejtave themelore të njeriut (pjesë e të cilave në mënyrë të pakontestueshme është edhe liria e fesë), si dhe në dinjitetin dhe vlerën e personalitetit të njeriut. Në këtë drejtim, pason një rishikim plotësues i alinesë 3 të nenit 1, ku janë përcaktuar qëllimet e KB-së, me ç'rast si sfidë e rëndësishme për organizatën botërore, mes tjerash, theksohet se **do të jetë edhe zhvillimi i bashkëpunimit ndërkombëtar gjatë zgjidhjes së kontesteve ndërkombëtare me karakter ekonomik, shoqëror, kulturor dhe humanitar, si dhe promovimi dhe inkurajimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë, pa marrë parasysh përkatësinë racore, gjinore, gjuhësore përfshirë këtu edhe përkatësinë fetare.**

Karta e KB-së ka rëndësi të jashtëzakonshme për promovimin e çështjes së mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në skenën politike ndërkombëtare<sup>44</sup>. Me të, si rezultat i tmerreve të mëdha me të cilat u ballafaqua njerëzimi në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore, u bënë përpjekje për institucionalizimin përfundimtar të çështjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, njohja e të cilave ka karakter universal<sup>45</sup>.

## 2.2. DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT DHE LIRITË E NJERIUT

Në themelin e dispozitave të Kartës, ndërlihet UDHR e cila është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës Botërore<sup>46</sup> më 10 dhjetor 1948<sup>47</sup>. Ky dokument ndërkombëtar ka për qëllim që në mënyrë plotësuese të ngritë dhe t'i risaktësojë standardet për të drejtat dhe liritë e njeriut. Me të, në historikun e të drejtave të njeriut, bëhet kalimi nga **"të drejta civile"** në **"të drejtat e njeriut"**, përkatësisht fillon vendosja e një sërë të instrumenteve ndërkombëtare në drejtim të mbrojtjes të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për mbarë njerëzimin<sup>48</sup>.

Në paragrafin 8 të Preambulës së UDHR, mes tjerash, theksohet se **"të gjithë njerëzit dhe kombet dhe për këtë qëllim secili individ dhe secili organ i shoqërisë, çdoherë (...) do të synojë që përmes mësimi dhe arsimit ta promovojnë respektimin e të drejtave dhe lirive të theksuara dhe përmes masave progresive**

<sup>43</sup> *Charter of the United Nations*, op.cit.

<sup>44</sup> Shih: Michael J Perry, *Toward a Theory of Human Rights*, Cambridge University Press, 2007 dhe Natan Lerner, *The Nature and Minimum Standards of Freedom of Religion or Belief*, Brigham Young University Law Review, 2000, f.: 905-932.

<sup>45</sup> Shih: Buihe P. Okenu, *The Right to Freedom of Religion vis a vis Religious Intolerance in the New Millennium*, punim diplome, University of Georgia School of Law, 2002.

<sup>46</sup> Asambleja e Përgjithshme e KB-së është njëri nga gjashtë organet kryesore të organizatës botërore, në të cilin të gjitha vendet-anëtare kanë përfaqësim të barabartë dhe të drejtë, mandati i të cilave përcaktohet në Kapitullin 4 të Kartës së KB-së. Kompetencat e këtij trupi kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e Buxhetit të KB-së, emërimin e shteteve-anëtare jo të përhershme në Këshillin e Sigurisë, pranimin e raporteve të cilat i hartojnë institucionet dhe trupat e KB-së dhe dhënien e propozimeve në formë të rezolutave deri te organet e tjera të organizatës botërore.

<sup>47</sup> Në paragrafin 5 të Preambulës së Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, mes tjerash, risaktësohet se ky dokument është vazhdim i frymës dhe dispozitave të Kartës së KB-së (*Universal Declaration of Human Rights*, Rezoluta 217 A (III), (un.org), op.cit.).

<sup>48</sup> Bernadette A. Meyler, *The Limits of Group Rights: Religious Institutions and Religious Minorities in International Law*, Cornell Law School, nr.: 08-013, 2008.

**kombëtare dhe ndërkombëtare do ta sigurojnë njohjen dhe respektimin e tyre efikas dhe të përgjithshëm, si midis popujve të vendeve-anëtare, ashtu edhe midis popujve në territoret nën juridiksionin e tyre”.** Sipas UDHR, të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta, me dinjitet dhe të drejta (neni 1) dhe secili ka të drejtën e jetës, lirisë dhe sigurisë (neni 3).

Në grupin e të drejtave civile dhe politike, **UDHR e përfshin edhe të drejtën e njeriut për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.** Kjo që u theksua më lart është specifikuar me nenin 18 sipas së cilit **secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë e përfshin edhe lirinë që njeriu ta ndryshojë fenë apo bindjen e tij, si dhe lirinë që njeriu, goftë individualisht ose bashkë me të tjerët, në mënyrë private ose publike ta manifestojë fenë apo bindjen e tij përmes edukimit, praktikimit, kultit ose riteve fetare.**

Analiza e këtij neni vë në pah së paku dy situata ligjore, që kanë të bëjnë me realizimin e lirisë së fesë.

- ❖ **Së pari**, secilit njeri në botë i garantohet liria e fesë;
- ❖ **Së dyti**, kjo liri nënkupton mundësi për ndryshimin e fesë, si dhe praktikimin e saj real nga ana e një apo më shumë personave bashkërisht, pavarësisht se a bëhet fjalë për privat ose publik.

Bazës së përcaktuar në këtë mënyrë i ndërlidhet neni 29, i cili i trajton çështjet e kufizimit të shfrytëzimit të të drejtave të njeriut. Në këtë aspekt, sipas paragrafit 2 të dispozitës së theksuar, në shfrytëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut **qytetarët mund të jenë objekt vetëm të llojeve të atilla të kufizimeve që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e të drejtave dhe lirive të njëjta nga ana e njerëzve të tjerë, si dhe lloje tjera të kufizimeve të cilat ndërlidhen vetëm me moralin e vendosur, rendin publik, si dhe me mirëqenien e përgjithshme në shoqëritë demokratike.**

### **2.3. PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE**

UDHR nuk është marrëveshje në kuptimin juridik-ndërkombëtar të fjalës, përkatësisht kjo Deklaratë ka vetëm karakter simbolik dhe konsultativ<sup>49</sup>. Në këtë drejtim bën fjalë edhe neni 13, paragrafi 1 nga Karta e KB<sup>50</sup>, në të cilin përcaktohet që ky lloj i rekomandimeve të përfshihet në marrëveshjet ndërkombëtare në mënyrë që ato të bëhen të detyrueshme për shtetet të cilat iu bashkëngjiten të njëjtave. Duke e pasur parasysh këtë që u tha më lart, në vitin 1951, Asambleja e Përgjithshme e KB-së miratoi Rezolutë<sup>51</sup> me të cilën i sugjeron Komisionit për të Drejtat e Njeriut pranë

<sup>49</sup> Shih: Milica Subotić, *Cultural Relativism for Universality of Human Rights - The Case of Reservations to Human Rights Treaties*, Center for Interdisciplinary Postgraduate Studies, University of Sarajevo/ University of Bologna, prill 2005.

<sup>50</sup> *Charter of the United Nations*, op.cit.

<sup>51</sup> Shih: Rezoluta 543/6, (un.org), 28.6.2012.

kësaj Organizate<sup>52</sup> të përpilojë propozim-tekst për dy pakte ndërkombëtare, prej të cilëve njëri do t'u përkushtohet të drejtave civile dhe politike, ndërsa tjetri të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Pastaj, **15 vjet pas këtij Rekomandimi iniciues, Asambleja e Përgjithshme e KB-së i miratoi të dy Paktet për të drejtat e jeriut, si vijojnë: Pakti Ndërkombëtar për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike.** Përmes tyre, dispozitat e UDHR, duke i përfshirë edhe ato për lirinë e fesë, u bënë **norma juridike të detyrueshme për shtetet të cilat iu bashkëngjiten të dy Pakteve,** meqë ato për dallim nga UDHR e kanë statusin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat nga aspekti juridik i obligojnë shtetet. Në këtë mënyrë, KB-ja si Organizatë Botërore, e cila i anticipon sfidat historike me të cilat ballafaqohet njerëzimi, bën ndikime plotësuese mbi rendin juridik-kombëtar të shteteve në drejtim të sigurimit të mbrojtjes gjithëpërfshirëse dhe garancive më të qëndrueshme në lidhje me të drejtat dhe liritë e njeriut.

Në Preambulën e këtyre dokumenteve, të cilat për nga përmbajtja janë identike, përcaktohet parimi i përgjithshëm i cili e specifikon kuptimin e tyre juridik dhe rëndësinë historike. Ai i referohet qëllimit për njohjen e dinjitetit inherent të anëtarëve të mbarë familjes së njerëzimit dhe të drejtat e tyre të barabarta dhe të pacenueshme, të cilat e paraqesin bazën e lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë.

Të dy Paktet nënkuptojnë detyrim për shtetet që të sigurojnë të drejta të barabarta për femrat dhe meshkujt, si dhe ta pamundësojnë diskriminimin në kuadër të territoreve të tyre në më shumë baza, siç është: raca, kultura, gjuha, mendimi politik ose mendim tjetër, origjina kombëtare ose sociale, si dhe përkatësia fetare.

Në aspekt të temës, është i rëndësishëm Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe veçanërisht neni 18<sup>53</sup>, sipas të cilit:

1. Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur ose për të pranuar një fe ose një besim prej tij, si dhe lirinë për të manifestuar fenë apo besimin e vet, qoftë individualisht apo së bashku me të tjerët, si publikisht ashtu edhe privatisht, nëpërmjet kultit dhe kryerjes së riteve, praktikave dhe edukimit.
2. Askush nuk duhet t'i nënshtrohet ndonjë shtrëngimi që do të mund të prekte lirinë e tij për të pasur ose për të pranuar një fe ose një besim të zgjedhur prej tij.
3. Liria e manifestimit të fesë apo të besimit të vet mund të bëhet objekt vetëm i kufizimeve të parapara me ligj dhe që janë të domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë, të rendit e të shëndetit publik, ose të moralit apo të lirive dhe të drejtave themelore të të tjerëve.

<sup>52</sup> Komisioni për të Drejtat e Njeriut të KB-së (UNCHR) është organ në përbërje të Këshillit Ekonomik Social të organizatës botërore. I njëjti funksionoi nga viti 1946 deri në vitin 2006 kur Asambleja e Përgjithshme e Organizatës Botërore e zëvendësoi me institucion tjetër, i cili e mban emrin Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Detyra kryesore e këtij trupi ishte, duke i marrë parasysh dokumentet përkatëse ndërkombëtare të KB-së nga fusha e të drejtave të njeriut për të hulumtuar, monitoruar dhe duke raportuar mbi realizimin e të njëjtave në shtete dhe territore të ndryshme të botës.

<sup>53</sup> *International Covenant on Civil and Political Rights*, op.cit.

4. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të respektojnë lirinë e prindërve dhe, kur është e zbatueshme, të kujdestarëve të ligjshëm për të siguruar edukimin fetar dhe moral të fëmijëve të tyre në përputhje me bindjet e tyre.

Krahasimi i nenit 9 nga UDHR me nenin 18 nga Pakti shpie në konkluzionin se komuniteti ndërkombëtar në fytyrën e KB-së bën saktësime plotësuese për lirinë e fesë, si dhe e zgjeron kuptimin e tij burimor, veçanërisht në 3 segmente:

- ❖ **Së pari**, ndalim për shtrëngimin e njerëzve në drejtim të asfiksimit ose mosrealizimit të lirisë së fesë;
- ❖ **Së dyti**, përcaktimi i kufijve se në cilat kushte mund të ndalohej realizimi i lirisë së fesë;
- ❖ **Së treti**, garanci për familjet (përkatesisht prindërve të fëmijëve, ndërsa në rast të caktuar kujdestarëve) në pjesën e lirisë për transmetimin e normave fetare familjare, përmes përcaktimit për sigurimin e edukimit përkatës fetar, pa u specifikuar mënyra me të cilën do të realizohet e njëjta.

Në këtë kontekst, është i rëndësishëm edhe neni 27 sipas të cilit, në shtetet në të cilat ekzistojnë minoritete etnike, fetare dhe gjuhësore, personat të cilët u përkasin këtyre minoriteteve nuk mund të privohen nga e drejta, bashkë me pjesëtarët e tjerë të grupit të tyre, të kenë jetë të veçantë kulturore, ta manifestojnë dhe ta praktikojnë fenë e tyre ose ta përdorin gjuhën e tyre. Ky nen, në vitet që pasojnë do të shfrytëzohet si **bazë** për miratimit e **Deklaratës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Jotolerancës në Bazë të Fesë ose Besimit**<sup>54</sup>, si dhe të **Deklaratës për të Drejtat e Personave të cilët u Përkasin Minoriteteve Etnike Kombëtare, Fetare dhe Gjuhësore**<sup>55</sup>, me të cilat organizata botërore edhe më thellë, në aspektin juridik-normativ, e rregullon lirinë e fesë.

## 2.4. DEKLARATA PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË JOTOLERANCËS DHE DISKRIMINIMIT NË BAZË TË RELIGJIONIT APO BESIMIT

Deklaratën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Jotolerancës dhe Diskriminimit në Bazë të Religjionit apo Besimit, Asambleja e Përgjithshme e Organizatës Botërore, e miratoi më 25 nëntor 1981<sup>56</sup>.

Procesi i miratimit përfundimtar të Deklaratës është **mjaft i gjatë**. Ai kalon në më së paku tri faza, me ç'rast në fazën e parë, e cila filloi në vitin 1962, u formësua koncepti i Deklaratës, në fazën e dytë nga viti 1972 u përpilua projekt-versioni i parë, ndërkaq në fazën e fundit, e cila filloi në vitin 1981, kur edhe përfundimisht u miratua

<sup>54</sup> *Declaration on the Elimination of All Forms of Intolerance and of Discrimination Based on Religion or Belief*, Rezoluta 36/55, (un.org), op.cit.

<sup>55</sup> *Declaration on the Rights of Persons Belonging to National or Ethnic, Religious and Linguistic Minorities*, Rezoluta 47/135, (un.org), op.cit.

<sup>56</sup> *Declaration on the Elimination of All Forms of Intolerance and of Discrimination Based on Religion or Belief*, op.cit.

ky dokument<sup>57</sup>. Shkaqet e kohëzgjatjes së këtij procesi nënkuptohet se janë **rezultat i qëndrimeve të kundërta midis shteteve-anëtare të Organizatës Botërore në lidhje me çështjen se çka nënkuptohet me jotolerancë fetare**. Në këtë drejtim, për shembull, më evidente është **çështja e ndryshimit të fesë**, me ç'rast kundrejt shteteve të civilizimit aksidental, të cilët një gjë të këtillë e njohin, në një pjesë të shteteve arabe islamike, ndryshimi i fesë interpretohet si shkelje e rëndë, e cila në raste të caktuara i nënshtrohet edhe dënimit me vdekje.<sup>58</sup> Në këtë drejtim, numri i vogël i garancive, që parashikohen në Deklaratë, si dhe fakti se e njëjta nuk parashikon kurrfarë detyrime ligjore për shtetet-nënshkruese janë konfirmim plotësues për konstatimin e deklaruar.

Deklarata për Eliminimin e të Gjitha Formave të Jotolerancës dhe Diskriminimit në Bazë të Religjionit apo Besimit përbëhet nga Preambula dhe 8 nene.

Me të, mes tjerash:

- ❖ **Së pari**, konfirmohet e drejta e secilit person për lirinë e fesë, të përcaktuar në nenin 9 të UDHR, si dhe nenin 18 të Paktit për të Drejta Civile dhe Politike (neni 1);
- ❖ **Së dyti**, ndalohet që kushdo qoftë të jetë objekt i diskriminimit që bazohet në religjion ose besim (neni 2);
- ❖ **Së treti**, sugjerohet në faktin se diskriminimi, që bazohet në religjion ose besim, është në kundërshtim me dinjitetin e njeriut dhe me këtë edhe me Kartën e KB-së, me ç'rast në këtë drejtim duhet të kualifikohet si shkelje e të drejtave dhe lirive të njeriut (neni 3);
- ❖ **Së katërti**, stimulohen të gjitha shtetet të ndërmarrin masa efektive për parandalimin dhe eliminimin e këtij lloji të diskriminimit (neni 4);
- ❖ **Së pesti**, duke e ndjekur logjikën e paragrafit të fundit të nenit 19 të Paktit për të Drejta Civile dhe Politike, parashikohet një sërë të drejtash të prindërve (përkatësisht kujdestarëve) dhe fëmijëve (neni 5). Përkatësisht:
  - E drejta e prindërve (kujdestarëve) ta organizojnë familjen, në përputhje me besimet e tyre;
  - E drejta e fëmijëve të kenë qasje në arsim që ka të bëjë me religjionin, në përputhje me dëshirat e prindërve;
  - Ndalim që fëmijët të diskriminohen në bazë të religjionit ose bindjes, si dhe
  - Detyrim sipas të cilit praktikimi i religjionit nga ana e fëmijëve nuk guxon të ndikojë mbi zhvillimin e tyre fizik ose psikik.
- ❖ **Së gjashti**, në përputhje me nenin 1 të Deklaratës, në të cilën është përcaktuar liria e fesë, parashikohen një sërë garancish (neni 6). Përkatësisht:

<sup>57</sup> Jose Luis Soberanes Fernandez, *Mexico and the 1981 United Nations Declaration on the Elimination of All Forms of Intolerance and of Discrimination Based on Religion or Belief*, Brigham Young University Law Review, 2002.

<sup>58</sup> Jose Luis Soberanes Fernandez, *Mexico and the 1981 United Nations Declaration on the Elimination of All Forms of Intolerance and of Discrimination Based on Religion or Belief*, op.cit.

- E drejta e qytetarëve të shoqërohen gjatë realizimit të lirisë së fesë;
- E drejta e formimit të organizatave humanitare, në kontekst të realizimit të lirisë së fesë;
- E drejta e hartimit dhe shfrytëzimit të teksteve dhe materialeve të tjera, në lidhje me realizimin e të drejtës së lartpërmendur;
- E drejta e edukimit fetar të njerëzve në vende përkatëse;
- E drejta e mbështetjes financiare;
- E drejta e trajnimit të njerëzve për çështje që kanë të bëjnë me fenë, si dhe
- E drejta e vendosjes së komunikimit në lidhje me realizimin e lirisë së fesë.

## 2.5. DEKLARATA PËR TË DREJTAT E PERSONAVE TË CILËT U PËRKASIN MINORITETEVE ETNIKE KOMBËTARE, FETARE DHE GJUHËSORE

Në vitin 1992, Asambleja e Përgjithshme e KB-së e miratoi edhe Deklaratën **për të Drejtat e Personave të cilët u Përkasin Minoriteteve Etnike Kombëtare, Fetare dhe Gjuhësore**<sup>59</sup>. Ashtu sikurse edhe Deklarata për Eliminimin e të Gjitha Formave të Jotolerancës dhe Diskriminimit në Bazë të Religjionit apo Besimit, edhe ky dokument paraqet një formë të rregullimit të butë juridik të kësaj fushe, me të cilin nuk parashikohen sanksione për shkeljen eventuale të dispozitave të tij nga ana e shteteve-nënshkruese.

Dokumenti përbëhet nga Preambula dhe 9 nene.

Me të:

- ❖ **Së pari**, përcaktohen të drejtat e personave të cilët u përkasin minoriteteve kombëtare, etnike, fetare dhe gjuhësore, përkatësisht:
  - E drejta e gëzimit të kulturës së vet, ta predikojnë dhe praktikojnë fenë e tyre dhe ta përdorin gjuhën e tyre, privatisht dhe publikisht (neni 2, paragrafi 1);
  - E drejta që lirisht dhe pa ndërhyrje ose çdo lloj diskriminimi, të marrin pjesë efektive në jetën kulturore, fetare, sociale, ekonomike dhe publike (neni 2, paragrafi 2);
  - E drejta që në mënyrë efektive të marrin pjesë në vendimet e nivelit kombëtar dhe rajonal që kanë të bëjnë me minoritetin të cilit ata i përkasin ose rajonit në të cilin ata jetojnë, në mënyrë që nuk do të jetë në kundërshtim me legjislacionin kombëtar (neni 2, paragrafi 3);
  - E drejta e themelimit dhe organizimit të asociacioneve të tyre (neni 2, paragrafi 4);
  - E drejta e themelimit dhe mbajtjes, pa kurrfarë diskriminimi, të kontakteve të lira dhe dashamirëse me anëtarë të tjerë të grupit të tyre dhe me persona, pjesëtarë të minoriteve të tjera, si dhe kontakteve jashtë kufijve me qytetarë të shteteve tjera, me të cilët kanë lidhje kombëtare ose etnike, fetare ose gjuhësore (neni 2, paragrafi 5), si dhe

<sup>59</sup> Declaration on the Rights of Persons Belonging to National or Ethnic, Religious and Linguistic Minorities, op.cit.

- E drejta e realizimit të të drejtave të tyre, përfshirë edhe ato që janë sanksionuar me Deklaratën aktuale, si individualisht ashtu edhe me anëtarë të tjerë të grupit të tyre në shoqëri, pa kurrfarë diskriminimi (neni 3, paragrafi 1).

❖ **Së dyti**, parashikohen **detyrime për shtetet**, përkatësisht:

- Detyrimi ta mbrojë qenien dhe identitetin kombëtar ose etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor të minoriteteve, në kuadër të territoreve të tyre përkatëse, si dhe të inkurajojnë kushte për promovimin e identitetit (neni 1);
- Detyrimi të ndërmarrin masa aty ku ka nevojë që të sigurohen se pjesëtarët e minoriteteve, në mënyrë të plotë dhe efektive, mund t'i realizojnë të drejtat e tyre njerëzore dhe liritë fundamentale pa kurrfarë diskriminimi dhe të barabartë para ligjit (neni 4, paragrafi 1);
- Detyrimi të ndërmarrin masa për krijimin e kushteve përkatëse që t'u mundësojnë pjesëtarëve të minoriteteve që t'i manifestojnë veçoritë e tyre dhe ta zhvillojnë kulturën, gjuhën, fenë, traditën dhe zakonet e tyre, përveç në rastet kur praktikime të veçanta e shkulin ligjin kombëtar dhe janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare (neni 4, paragrafi 2);
- Detyrimi të ndërmarrin masa në mënyrë që aty ku është e mundshme, pjesëtarët e minoriteteve të kenë mundësi adekuate për mësimin e gjuhës së tyre amtare ose të fitojnë instruksione në gjuhën e tyre amtare (neni 4, paragrafi 3);
- Detyrimi të ndërmarrin masa në fushën e arsimit me qëllim të stimulimit të njohjes së historisë, traditave, gjuhës dhe kulturës të minoriteteve të cilët ekzistojnë në territorin e tyre (neni 4, paragrafi 4);
- Detyrimi të ndërmarrin masa në mënyrë që pjesëtarët e minoriteteve të mund të participojnë plotësisht në progresin dhe zhvillimin ekonomik të vendit të tyre (neni 4, paragrafi 5), si dhe
- Detyrimi të bashkëpunojnë me shtete të tjera për çështje që kanë të bëjnë me pjesëtarët e minoriteteve, mes tjerash, duke shkëmbyer informata, me qëllim të promovimit të mirëbesimit dhe mirëkuptimit (neni 7).

### 3. KËSHILLI I EVROPËS DHE LIRIA E FESË

Këshilli i Evropës është organizatë rajonale ndërkombëtare, e themeluar në 5 maj 1949 me qëllim të promovimit më të madh të bashkëpunimit midis shteteve të kontinentit evropian, si dhe me qëllim të promovimit të demokracisë dhe të drejtave të njeriut dhe sundimit të së drejtës<sup>60</sup>. Nga aspekti i temës së punimit, të rëndësishëm janë dy dokumentet ndërkombëtare të kësaj organizate ndërkombëtare, si vijojnë:

<sup>60</sup> Për rëndësinë e Këshillit të Evropës për promovimin e lirisë së fesë, shih: Simon Barnett, *Religious Freedom and the European Convention on Human Rights: the Case of the Baltic States*, Religion, State & Society nr.: 2, 2001, f.: 91-100.



- ❖ **Së pari, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ)<sup>61</sup>, si dhe**
- ❖ **Së dyti, Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare<sup>62</sup>.**

### **3.1. KONVENTA EVROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE**

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore u miratua më 4 nëntor të vitit 1950 dhe e ka formën e marrëveshjes ndërkombëtare e hapur për nënshkrim nga ana e shteteve-anëtare të KiE<sup>63</sup>. Nga viti 1950, KEDNJ është amenduar dymbëdhjetë herë përmes një sërë protokollesh. Sa i përket temës së punimit, e rëndësishme është Preambula e marrëveshjes, e cila i referohet UDHR, si dhe neni 1 sipas së cilit shtetet-nënshkruese të gjithë personave në kompetencë të tyre ua njohin të drejtat dhe liritë e përcaktuara me Konventën. Në këtë drejtim, korniza vendoset edhe me nenin 14 sipas të cilit gëzimi i të drejtave dhe lirive, të njohura me KEDNJ, duhet të sigurohet pa kurrfarë diskriminimi që bazohet në: gjini, racë, ngjyrën e lëkurës, gjuhën, mendimin politik ose ndonjë mendim tjetër, origjinën kombëtare ose sociale, përkatësinë në minoritetin kombëtar, pozitën materiale, origjinën e lindjes ose cilitdo qoftë status tjetër, përfshirë këtu edhe besimin fetar, si dhe nenet 19 dhe 32, me të cilët parashikohet themelimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është kompetente për të gjitha çështjet në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Konventës dhe protokolleve të saj.

Kornizës së specifikuar në këtë mënyrë i ndërlidhet neni 9 me të cilin përcaktohen kufijtë e lirisë së fesë. Përkatësisht, sipas kësaj dispozite:

1. Secili njeri e ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë e përfshin lirinë e ndryshimit të fesë dhe bindjes, si dhe lirinë e manifestimit të fesë dhe bindjes së vet, qoftë vet ose bashkë me të tjerët, publikisht ose privatisht, përmes shërbesës fetare, edukimit, predikimit, kultit dhe riteve fetare.
2. Liria e manifestimit të fesë ose bindjeve të veta mund të jetë objekt vetëm i atyre kufizimeve të specifikuara me ligj, të cilat nënkuptojnë masa në interes të sigurisë publike, rendit, shëndetit dhe moralit, ose mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve, të domosdoshme në një shoqëri demokratike.

Struktura e dispozitës, që ka të bëjë me realizimin e lirisë së fesë, si dhe nenet e tërthorta në lidhje me çështjen e mosdiskriminimit dhe kufizimit të lirive dhe të drejtave, në të vërtetë janë të njëjta me dispozitat përkatëse të dokumentit të KB-së. Megjithatë, **dallimi i vetëm jashtëzakonisht i rëndësishëm ka të bëjë me fuqinë juridike të Konventës. Përkatësisht, për dallim nga dokumentet e miratuara nga KB-ja, shtetet-anëtare të KiE me KEDNJ heqin dorë nga një pjesë e**

<sup>61</sup> *European Convention on Human Rights*, Council of Europe Treaty Series, No. 5.

<sup>62</sup> *Framework Convention for the Protection of National Minorities*, Council of Europe (conventions.coe.int), 29.6.2012.

<sup>63</sup> *European Convention on Human Rights*, op.cit.

**sovrانيتit të tyre, që ka të bëjë me kompetencat e gjykatave kombëtare, duke ia deleguar autorizimin Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vendimet e së cilës janë të detyrueshme për shtetet. Gjykata, nga ana tjetër, duke vepruar sipas parashtrësive të personave nga shtetet-anëtare të kësaj organizate ndërkombëtare evropiane, ofron një spektër të gjerë të informatave të cilat në mënyrë plotësuese hedhin dritë në lidhje me kuptimin dhe përfshirjen e lirisë së fesë përkatëse.** Duke e pasur parasysh këtë që u tha më lart, në vazhdim do t'u prezantojmë një vështrim më të përafërt në lidhje me gjashtë vendime gjyqësore më karakteristike të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht:

- ❖ **Së pari**, Vendimi në kontestin *Kokkinakis v. Greece*<sup>64</sup>;
- ❖ **Së dyti**, Vendimi në kontestin *Kalac v. Turkey*<sup>65</sup>;
- ❖ **Së treti**, Vendimi në kontestin *Cha'are Shalom Ve Tsedek v. France*<sup>66</sup>;
- ❖ **Së katërti**, Vendimi në kontestin, *Pretty v. the The United Kingdom*<sup>67</sup>;
- ❖ **Së pesti**, Vendimi në kontestin *Feti Demirtas v. Turkey*<sup>68</sup>, si dhe
- ❖ **Së gjashti**, Vendimi në kontestin *Soile Lautsi dhe të tjerë v. Italy*<sup>69</sup>.

Në rastin **Kokkinakis v. Greece** nga viti 1992, personi në fjalë e paditë Greqinë meqë është akuzuar për proselitizëm<sup>70</sup> nga ana e shtetit, e që ai konsideron se bëhet fjalë për realizimin e lirisë së tij të besimit fetar. Gjykata, duke vepruar sipas padisë, në bazë të nenit 9 të Konventës, vendos në favor të Kokkinakis duke e risaktësuar kuptimin e dispozitës së KEDNJ e cila ka të bëjë me realizimin e lirisë së fesë edhe atë veçanërisht në dy segmente:

- ❖ **Së pari**, liria e fesë është një nga themelet e shoqërisë demokratike, e cila e përcakton identitetin e besimtarëve, por edhe të ateistëve, agnostikëve, skeptikistëve dhe të pa interesuarve (pika 31<sup>71</sup>);
- ❖ **Së dyti**, liria e manifestimit të fesë në vetvete e ndërthet edhe të drejtën që dikush të bindet në besimet përkatëse (pika 31<sup>72</sup>).

Në rastin **Kalac v. Turkey** nga viti 1997 personi në fjalë, i cili punon në armatën turke, është pensionuar para kohe nga ana e institucioneve përkatëse, me procedurë përkatëse, meqë duke e pasur parasysh sjelljen e tij, është vlerësuar se i njëjti ka pranuar mendim të palejuar fundamentalist fetar<sup>73</sup>. Gjykata, duke vepruar sipas padisë, ndërkaq në bazë të nenit 9 të Konventës, vendos se shtetasi i Turqisë nuk e ka shkelur KEDNJ. Nga Vendimi gjyqësor mund të nxirren dy konkluzione shtesë, të cilët në mënyrë plotësuese hedhin dritë mbi karakterin e lirisë së fesë. Përkatësisht, sipas Gjykatës:

<sup>64</sup> *Kokkinakis v. Greece*, 3/1992/348/421, European Court of Human Rights (echr.coe.int), 28.6.2012.  
<sup>65</sup> *Kalac v. Turkey*, 61/1996/680/870, European Court of Human Rights (echr.coe.int), 28.6.2012.  
<sup>66</sup> *Cha'are Shalom VeTsedek v. France*, 27417/95, European Court of Human Rights (echr.coe.int), 28.6.2012.  
<sup>67</sup> *Pretty v. the The United Kingdom*, 2346/02 European Court of Human Rights (echr.coe.int), 28.6.2012.  
<sup>68</sup> *Feti Demirtas v. Turkey*, 5260/07, European Court of Human Rights (echr.coe.int), 28.6.2012.  
<sup>69</sup> *Lautsi v. Italy*, App. No. 30814/06, 2011, European Court of Human Rights (echr.coe.int), 28.6.2012.  
<sup>70</sup> Proselitizmi është akt me të cilin bëhen përpjekje që një person të konvertohet në fe ose besim tjetër.  
<sup>71</sup> *Kokkinakis v. Greece*, 3/1992/348/421, op.cit.  
<sup>72</sup> Ibid.  
<sup>73</sup> Shih: *The Encyclopedia of Political Science*, op.cit., f.: 642-644.

- ❖ **Së pari**, liria e fesë shprehimisht i ngërthen në vete të gjitha procedurat e një personi në lidhje me realizimin e tyre. Sipas kësaj, secili duhet që gjatë ndërmarrjes së hapave të caktuara të mbaj llogari për gjendjen e tij specifike fetare (pika 27<sup>74</sup>), si dhe
- ❖ **Së dyti**, rregullat brenda institucioneve (siç është armata), janë të përcaktuara, ndërsa njerëzit e angazhuar në to, të njëjtat i pranojnë meqë vendimi i miratuar nuk ka lidhje me lirinë e fesë por me sjelljen dhe qëndrimet në vendin e punës (pika 28<sup>75</sup>).

Në rastin **Cha'are Shalom Ve Tsedek v. France** nga viti 1987, asociacioni i parashtruesit të padisë, duke e ndjekur procedurën e përcaktuar ligjore, kërkon nga ministri i Punëve të Brendshme të Francës leje që të paraqes kërkesë deri te Ministria e Bujqësisë që t'i jepet leje zyrtare për therjen e kafshëve, që paraqet ritual religjioz të këtij asociacioni hebraik. Edhe pse tanimë ekziston institucioni legjitim, i cili i kryen këto rituale, sipas parashtruesit të njëjtat nuk janë bërë në mënyrë të drejtë dhe prandaj kanë vendosur ta ndërmarrin këtë hap. Si përfundim, aplikimi i parashtruesit është refuzuar në instancë të fundit. Gjykata, duke e pasur parasysh nenin 9 dhe nenin 14 të KEDNJ, konsideron se Franca nuk i ka shkelur nenet përkatës. Në këtë drejtim, nga ky vendim i Gjykatës mund të nxirren tre konkluzione, të cilët në mënyrë plotësuese hedhin dritë mbi karakterin e lirisë së fesë. Me fjalë të tjera, sipas Gjykatës:

- ❖ **Së pari**, me mosrealizimin e lirisë së fesë mund të nënkuptohet akti me të cilin një procedurë e caktuar fetare është kualifikuar si jolegale, përkatësisht e ndaluar (pika 80/81<sup>76</sup>);
- ❖ **Së dyti**, karakteri i realizimit të lirisë së fesë nuk varet nga përshtypja individuale në lidhje me ekzistimin apo mosekzistimin e kushteve për realizimin e ritualeve përkatëse fetare (pika 83<sup>77</sup>), si dhe
- ❖ **Së treti**, realizimi i të drejtës së fesë nuk duhet ta rrezikojë realizimin e të drejtave dhe lirive të tjera të njeriut (pika 84<sup>78</sup>).

Në rastin **Pretty v. the United Kingdom**, personi në fjalë e padit shtetin e vet, meqë edhe pse lëngon nga një sëmundje e rëndë, në përputhje me ligjet e Mbretërisë së Bashkuar, nuk është e mundur të bëhet vrasje nga mëshira/eutanazi, për çka mendon se, mes tjerash, është shkelur neni 9 i KEDNJ meqë kjo e ka nënkuptuar besimin e saj fetar. Gjykata, duke vepruar sipas padisë, vendos se Mbretëria e Bashkuar nuk e ka shkelur Konventën, me ç'rast nxjerr dy konkluzione të rëndësishme të cilat në mënyrë më të saktë e përcaktojnë karakterin e lirisë së fesë:

- ❖ **Së pari**, të gjitha mendimet apo bindjet e njerëzve nuk mundet të përfshihen me kategorinë fetar, si dhe
- ❖ **Së dyti**, neni 9 i KEDNJ absolutisht nuk i përshin të gjitha manifestimet të cilat janë motivuar për shkaqe fetare, por vetëm themeloret.

<sup>74</sup> *Kalac v. Turkey*, 61/1996/680/870.

<sup>75</sup> *Ibid.*

<sup>76</sup> *Cha'are Shalom VeTsedek v. France*, 27417/95, op.cit.

<sup>77</sup> *Ibid.*

<sup>78</sup> *Ibid.*

Rasti **Feti Demirtas v. Turkey** është pjesë e grupit të rasteve të cilat i shqyrton Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut që kanë të bëjnë me shkeljen e nenit 9 të KEDNJ, lidhur me të drejtën e kundërshtimit për shkak të ndërgjegjes. Në këtë rast, personi në fjalë e paditë Republikën e Turqisë, meqë si pjesëtar i komunitetit fetar, "Dëshmitarët e Jehovait" edhe pse deklaroi para organeve përkatëse se nuk dëshiron ta shërbejë afatin ushtarak me armë, për shkak të bindjeve të tij fetare, duke kërkuar që këtë obligim ta kryej përmes angazhimeve civile, kjo e drejtë nuk i është mundësuar. Gjykata, duke vepruar sipas padisë, në bazë të nenit 9 të Konventës, vendos në favor të Demirtas në atë mënyrë duke e risaktësuar kuptimin e dispozitës të KEDNJ në lidhje me realizimin e lirisë së fesë, në pjesën e të drejtës së kundërshtimit të ndërgjegjes edhe atë në dy segmente:

- ❖ **Së pari**, edhe pse neni 9 i KEDNJ nuk e parashikon në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtën e kundërshtimit të ndërgjegjes, megjithatë e njëjta nënkuptohet, si dhe
- ❖ **Së dyti**, liria e fesë nënkupton një trajtim të ndershëm dhe përkatës nga ana e shtetit ndaj minoriteteve fetare, e që nënkupton ofrim të mundësive që të kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë, në mënyrë e cila korrespondon me bindjet e tyre.

Në rastin **Lautsi dhe të tjerë v. Italy** personi, pasi që i ka shfrytëzuar të gjitha mekanizmat juridikë në Republikën e Italisë, i drejtohet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me praninë e simboleve religjioze (kryqe) nëpër klasat e shkollave në atë shtet. Përkundër Vendimit të parë nga Seksioni i dytë i Gjykatës, nga viti 2009, me të cilin u konstatua se Republika e Italisë, meqë e ka shkelur nenin 9 të KEDNJ, i cili ka të bëjë me lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, duke vendosur në favor të Lautsi-t dhe të tjerëve, megjithatë, në sesionin plenar, në muajin mars të vitit 2011, Gjykata merr vendim të formës së prerë, duke vendosur se Italia nuk e ka shkelur nenin 9 të KEDNJ<sup>79</sup>. Në të vërtetë, sipas Gjykatës, në shtetet me traditë krishtere, krishterimi gëzon legjitimitet të veçantë shoqëror, me ç'rast i njëjti veçohet nga sistemet e tjera filozofike dhe religjioze. Me fjalë të tjera, sipas Gjykatës, meqë Italia është shtet me traditë krishtere, simbolet e kësaj feje mund të gëzojnë vizibilitet të veçantë kundrejt simboleve të tjera religjioze ose ideologjike. Në këtë mënyrë, Gjykata në mënyrë plotësuese e risaktësoi dispozitën e KEDNJ që ka të bëjë me realizimin e lirisë së fesë, edhe atë veçanërisht në tre segmente:

- ❖ **Së pari**, KEDNJ nuk ua ndalon shteteve që publikisht ta predikojnë fenë dominante, mes tjerash, edhe me vendosjen e simboleve religjioze (kryqe) nëpër klasa dhe shkolla;
- ❖ **Së dyti**, me KEDNJ kërkohet nga shtetet të veprojnë në mënyrë neutrale ndaj qytetarëve që nuk e nënkupton atë se shteti në bazë duhet të jetë neutral, si dhe
- ❖ **Së treti**, me KEDNJ shtetet nuk kanë obligim të veprojnë në mënyrë neutrale në çdo kohë dhe për të gjitha çështjet, por vetëm kur bëhet fjalë për liritë dhe të drejtat personale të qytetarëve.

<sup>79</sup> *Lautsi v. Italy*, App. No. 30814/06, 2011, op.cit.

### 3.2. KONVENTA KORNIZË PËR MBROJTJEN E MINORITETEVE KOMBËTARE

Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare u miratua në vitin 1995<sup>80</sup>. Ky është instrumenti i parë i detyrueshëm multilateral juridik për mbrojtjen në përgjithësi të minoriteteve kombëtare, ndërkaq zbatohet përmes ligjeve dhe politikave kombëtare. Nga aspekti i temës së punimit, pesë dispozita janë të rëndësishme, të cilat hedhin dritë të re mbi zhvillimin e lirisë së fesë. Në të vërtetë, nisur nga fakti sipas të cilit mbrojtja e minoriteteve kombëtare dhe të drejtave e lirive të pjesëtarëve të atyre minoriteteve, janë pjesë integrale e mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe si të këtilla paraqesin fushë të bashkëpunimit ndërkombëtar (neni 1). Në thelbin e kësaj që u tha më lart, vihet në pah se shtetet e kanë për detyrë t'i avancojnë kushtet që t'u mundësojnë pjesëtarëve të minoriteteve kombëtare ta ruajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre, si dhe t'i ruajnë elementet esenciale të identitetit të tyre – fenë e tyre, gjuhën e tyre, traditat e tyre dhe trashëgiminë e tyre kulturore (neni 5). Në vazhdim, sipas nenit 6, shtetet obligohen që ta stimulojnë frymën e tolerancës dhe dialogun ndërkulturor, si dhe të ndërmarrin masa efektive për avancimin e respektimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit midis të gjithë personave të cilët jetojnë brenda territorit të tyre, pa marrë parasysh identitetin e tyre etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar, veçanërisht në fushën e arsimit, kulturës dhe mediave. Me nenin 7, shtetet obligohen që çdo pjesëtar i të minoritetit kombëtar t'ia sigurojnë respektimin e të drejtës së lirisë për tubime të qeta, lirinë e shoqërimit, lirinë e shprehjes dhe lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, si dhe sipas nenit 8, çdo pjesëtar i të minoritetit kombëtar t'ia njohin të drejtën e manifestimit të fesë ose bindjes së tij, si dhe të drejtën e formimit të institucioneve, organizatave dhe shoqatave fetare. Përfundimisht, sipas nenit 17, shtetet nënshkruese të dokumentit obligohen të mos ua pengojnë të drejtën pjesëtarëve të minoriteteve kombëtare që lirisht dhe me dashamirësi të mbajnë kontakte me persona nga ana tjetër e kufirit, të cilët nga aspekti ligjor gjenden në shtete tjera, veçanërisht me ata me të cilët kanë identitet të përbashkët etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar ose trashëgimi të përbashkët kulturore.

<sup>80</sup> *Framework Convention for the Protection of National Minorities*, op.cit.

## PIKËPAMJE PËRFUNDIMTARE

Në bazë asaj që u theksua më lart, mund të nxjerrim më shumë pikëpamje përfundimtare sa u përket standardeve ndërkombëtare-juridike për lirinë e fesë dhe RM.

1. KB-ja, si organizatë universale ndërkombëtare në botë i vendosi standardet në lidhje me realizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, pjesë e drejtpërdrejtë të të cilës janë liritë dhe të drejtat fetare, me ç'rast Karta e KB-së, me të cilën u themelua kjo organizatë, e ka rëndësinë më të madhe. Me të u bënë angazhime për institucionalizimin përfundimtar të çështjeve të lartpërmendura, meqë për herë të parë në historinë e njerëzimit vendosen standarde të cilat janë të detyrueshme për të gjitha shtetet e botës. Në themelin e dispozitave të Kartës ndërlidhet UDHR. Me këtë dokument ndërkombëtar, i cili e ka për qëllim në mënyrë plotësuese t'i ngritë dhe t'i risaktësojë standardet për të drejtat dhe liritë e njeriut, bëhet kalimi nga "të drejtat civile" në "të drejtat e njeriut". Në grupin e të drejtave civile dhe politike, UDHR e përfshin edhe të drejtën e njeriut për lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë e përfshin edhe lirinë që njeriu ta ndryshojë fenë ose bindjen e tij, si dhe lirinë njeriu qoftë individualisht ose në bashkësi me të tjerë, privatisht ose publikisht ta manifestojë fenë ose bindjen e tij përmes edukimit, praktikimit, kultit, riteve fetare. Pastaj, 15 vjet pas rekomandimit të këtillë iniciues, me miratimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe me Paktin Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike, dispozitat e UDHR, përfshirë edhe ato për lirinë e fesë, u shndërruan në norma të detyrueshme ligjore për shtetet të cilat iu bashkëngjiten të dy Pakteve, meqë ato, për dallim nga UDHR, kanë statusin e marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat juridikisht i obligojnë shtetet. Në këtë mënyrë, KB-ja ka ndikim plotësues mbi rendin juridik kombëtar në drejtim të sigurimit të mbrojtjes gjithëpërfshirëse të të drejtave dhe lirive të njeriut.
2. KiE gjithashtu, ka ndikim të rëndësishëm mbi zhvillimin e standardeve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave dhe lirive fetare, më së shumti përmes KEDNJ, si dhe përmes Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare. Duke e analizuar karakterin e dokumenteve, mund të konkludojmë se të njëjtit paraqesin rishikime plotësuese por edhe risaktësime të mëtutjeshme sa i përket lirisë së fesë. Proceset e këtilla në KiE, si organizatë më e vjetër evropiane janë të karakterit permanent, veçanërisht përmes prizmit të rolit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila, siç e pamë, në vazhdimësi i zhvillon standardet në këtë fushë. Në mënyrë konsekuente për atë që u tha më lart, gjithashtu duke e pasur parasysh rëndësinë e kësaj organizate, e njëjta ka një ndikim jashtëzakonisht të rëndësishëm mbi kombet e tjerë të kontinentit evropian, të cilët pavarësinë e fituan pas themelimit të saj për përmbushjen më të shpejtë të këtyre standardeve demokratike jashtëzakonisht të rëndësishme. Së fundmi, në këtë këndvështrim, KiE në mënyrë të tërthortë ndikon edhe mbi shtetet në pjesët e tjera të botës, të cilat për shkaqe të ndryshme kanë një nivel të zhvillimit më të ulët demokratik, me ç'rast në një mënyrë të caktuar e përcaktojnë edhe agjendën e KB-së në aspekt të zgjerimit të më-

tutjeshëm të standardeve të përcaktuara demokratike të kontinentit evropian në mbarë botën.

3. RM, si shtet-anëtar i KB-së dhe i KiE, ndërsa në përputhje me Kushtetutën i ka njohur dokumentet përkatëse, me ç'rast të njëjtat bëhen pjesë të rendit tonë juridik. Në bazë të asaj që u tha më lart, mund të konkludohet se shteti në mënyrë konsekuente i respekton standardet e këtilla, në atë mënyrë duke e dhënë kontributin e vet në afirmimin e tyre të mëtutjeshëm. Megjithatë, duke i marrë parasysh rrethanat e përgjithshme, duhet të vazhdojë fokusi institucional për tejkalimin e sfidave të tjera, në një pjesë të kësaj fushe jashtëzakonisht dinamike, në përputhje me normat dhe frymën e standardeve të analizuara ndërkombëtare. Sfidat e këtilla kryesisht kanë të bëjnë me ndërtimin e konsensusit shtetëror në lidhje me "kufijtë e shekullarizmit maqedonas" i cili, nga ana tjetër, përfshin një sërë të çështjeve komplekse të cilat kanë të bëjnë me shkallën e pranisë së religjionit në jetën politike dhe institucionale, por edhe në arsim, shëndetësi, kulturë dhe në përgjithësi në jetën publike të qytetarëve të cilët janë të lirë të vendosin nëse dhe cilës fe do t'i përkasin, ta ndryshojnë fenë dhe gjithsesi qoftë vet ose në bashkësi me të tjerë ta praktikojnë fenë e tyre.

## **ABSTRACT**

### **REPUBLIC OF MACEDONIA AND THE INTERNATIONAL LEGAL STANDARDS ON THE FREEDOM OF RELIGIOUS BELIEF**

Today the protection of the religious rights and freedoms is an extremely serious task, because it means that coherent legal rules are necessary to enable balance in exercising the rights and duties of all citizens – the believers of the different faiths and the non-believers. Taking this into consideration, the international organizations, as well as the sovereign democratic states, are trying to find appropriate legal solutions related to these important issues.

The Republic of Macedonia as a democratic European state is constructing a constitutional and political system that is founded on these essential legal standards of the developed world. They, in turn, found its legal expression in the documents of the relevant international governmental organizations accepted by our state. In this regard, the relevant documents of the United Nations and of the Council of Europe, as organizations in which the Republic of Macedonia is a member state, in accordance with the norms of our constitution, are part of our internal legal order.

Considering the aforementioned, in this paper, the questions related to the freedom of religious belief are revealed in the four sections, whereby in the first section entitled “theoretical-historical overview” an overview is presented of the development of the ideas for the freedom of religion throughout the history. The second section entitled “The United Nations and the freedom of religious belief”, contains legal analysis of the meaning and scope of the freedom of religious belief in the documents of this world organization, while the third section titled: “The Council of Europe and the freedom of religious belief” contains an identical analysis, as in the previous section, related to the this oldest European regional organization. On the foundation of the presented information in all parts of this paper, the last section titled “concluding observations” includes the findings related to the scope of the freedom of religious belief in the Republic of Macedonia.



## LITERATURA E PËRDORUR

1. Biran Tierney, *The Idea of Natural Rights: Studies on Natural Rights, Natural Law and Church Law 1150-1625*, 1997
2. Darek H. Davis, *The Evolution of Religious Freedom as a Unoversal Human Right: Examing the Role of the 1981 United Nation Declaration on the Eliiination of All Forms of Intolerance and of Discrimination Based on Religion or Belief*, Brigham Young University Law Review, 2002, f.: 220
3. Oded Haklai, *Religious–Nationalist Mobilization and State Penetration Lessons From Jewish Settlers’ Activism in Israel and the West Bank*, Comparative Political Studies 6p.: 6, Sage Publications, qershor 2007, f.: 713-730.
4. AlexanderKyrlezhev, *RelationshipsBetweenHumanRightsConceptAndReligious-Values*, Religionin EasternEurope nr.: 1, shkurt 2007, f.: 41-47.
5. James F. Harris, *Religion and Liberal Democracy*, The Humanist, maj-qershor 2006, f.: 26-30 dhe Brice Dickson, *The United Nations and the Freedom of Religion*, International and Comparative Law Quarterly, 1995, f.: 327.
6. Daniel Philpott, *Religious Freedom and the Undoing of the Westphalian State*, Michigan Journal of International Law, në verën e vitit 2004, f.: 981-998; A. Raymond Randolph, *Spreading Democracy*, Northwestern University Law Review nr.: 1, 2008, f.: 431-432
7. Louis René Beres, *Religious Extremism and International Legal Norms: Perfidy, Preemption, and Irrationality*, Case Western Reserve Journal of International Law nr.: 39, f.: 709-730.
8. *Partitë politike dhe kufijtë e shekullarizmit në Republikën e Maqedonisë*, Fondacioni “Konrad Adenauer”, Policy Brief, Shkup, 2014
9. *Ndikimi i komuniteteve fetare mbi institucionet dhe politikën e Republikës së Maqedonisë*, Fondacioni, “Konrad Adenauer”, Policy Brief, Shkup, 2015.
10. Rex Ahdar dhe Ian Leigh, *Religious Freedom in the Liberal State*, Oxford University Press, 2005.
11. Theo C. Van Boven, *Religious Liberty in the Context of Human Rights*, The Ecumenical Review, f.: 345-355
12. Michael W. McConnell, *Religious Freedom, Separation of Powers, and the Reversal of Roles*, Brigham Young University Law Review, 2001, f.: 611-618.
13. ArcortKrishnaswami, *Study of Discrimination in the Matter of Religious Rights and Practicies*, United Nations, 1960, f.:2.
14. Jay A. Sigler, *Minoritie Rights: A Comparative Analysis*, Greenwood Press, 1983, f.: 41
15. *The Lack of Legislative Power, The Midle Ages: Readings in Medieval History*, 1970.
16. *Declaration of Independence*, (archives.gov), 7.11.2011.
17. *Declaration of the Rights of Man and of the Citizen*, (hrcr.org), 7.11.2011.
18. John Locke, *A Letter Concerning Toleration*, Prometheus Books, 1990.
19. James E. Wood, *Religious Human Rights and aDemocratic State*, Journal of Church and State, f.: 739-765 dhe Bernadette Meyler, *The Limits of Group Rights: Religious Institutions and Religious Minorities in International Law*, St. John’s Journal of Legal Commentary nr.: 2, f.: 535-558.

20. Benjamin Straumann, *The Peace of Westphalia as a Secular Constitution*, Constellations nr.: 2, 2008.
21. Margaret MacMillan, *Paris 1919: Six Months That Changed the World*, Random House Publishing Group, 2007.
22. Thomas J Curry, *The First Freedoms: Church and State in America to the Passage of the First Amendment*, Oxford University Press, 1986.
23. Michael J. Malbin, *Religion and Politics: The Intentions of the Authors of the First Amendment*, American Enterprise Institute for Public Policy Research, 1978
24. William Lee Miller, *The First Liberty: Religion and the American Republic*, Alfred A. Knopf, 1986.
25. Philip Schaff, *Church and State in the United States or the American Idea of Religious Liberty and Its Practical Effect*, G. P. Putnam's Sons, 1888.
26. J. Paul Martin, *Religions, Human Rights, and Civil Society: Lessons from the Seventeenth Century for the Twenty-First Century*, Brigham Young University Law Review, 2000, f.: 933-944
27. Orrin G. Hatch, *Religious Liberty at Home and Abroad: Reflections on Protecting this Fundamental Freedom*, Brigham Young University Law Review, 2001, f.: 413-428.
28. Daniel Wehrenfennig, *The Human Right of Religious Freedom in International Law*, Peace Review: A Journal of Social Justice nr.: 18, f.: 403-410.
29. Steven K. Green, *Religious Liberty as a Positive and Negative Right*, Albany Law Review nr.: 70, 2007, f.: 1453-1472.
30. Lucas Swaine, *The Liberal Conscience: Politics and Principle the World of Religious Pluralism*, Cambridge University Press, 2006.
31. Michael J. Perry, *The Morality of Human Rights: A Nonreligious Ground?*, Emory Law Journal nr.: 54, f.: 97-150.
32. *Charter of the United Nations* (treaties.un.org), 28.6.2012.
33. *Universal Declaration of Human Rights*, Rezoluta 217 A (III), (un.org), 28.6.2012.
34. *International Covenant on Civil and Political Rights*, Rezoluta 2200A (XXI), (un.org), 28.6.2012.
35. *Declaration on the Elimination of All Forms of Intolerance and of Discrimination Based on Religion or Belief*, Rezoluta 36/55, (un.org), 28.6.2012.
36. *Declaration on the Rights of Persons Belonging to National or Ethnic, Religious and Linguistic Minorities*, Rezoluta 47/135, (un.org), 28.6.2012.
37. Michael J Perry, *Toward a Theory of Human Rights*, Cambridge University Press, 2007
38. Natan Lerner, *The Nature and Minimum Standards of Freedom of Religion or Belief*, Brigham Young University Law Review, 2000, f.: 905-932.
39. Buihe P. Okenu, *The Right to Freedom of Religion vis a vis Religious Intolerance in the New Millennium*, punim përi diplomë, University of Georgia School of Law, 2002.
40. Bernadette A. Meyler, *The Limits of Group Rights: Religious Institutions and Religious Minorities in International Law*, Cornell Law School, nr.: 08-013, 2008.
41. Milica Subotić, *Cultural Relativism for Universality of Human Rights - The Case of Reservations to Human Rights Treaties*, Center for Interdisciplinary Postgraduate Studies, University of Sarajevo/University of Bologna, prill 2005.
42. Rezoluta 543/6, (un.org), 28.6.2012.

43. Jose Luis Soberanes Fernandez, *Mexico and the 1981 United Nations Declaration on the Elimination of All Forms of Intolerance and of Discrimination Based on Religion or Belief*, Brigham Young University Law Review, 2002.
44. Simon Barnett, *Religious Freedom and the European Convention on Human Rights: the Case of the Baltic States*, Religion, State & Society nr.: 2, 2001, f.: 91-100.
45. *European Convention on Human Rights*, Council of Europe Treaty Series, No. 5.
46. *Framework Convention for the Protection of National Minorities*, Council of Europe (conventions.coe.int), 29.6.2012.
47. *Kokkinakis v. Greece*, 3/1992/348/421, European Court of Human Rights (echr.coe.int), 28.6.2012.
48. *Kalac v. Turkey*, 61/1996/680/870, European Court of Human Rights (echr.coe.int), 28.6.2012.
49. *Pretty v. the The United Kingdom*, 2346/02 European Court of Human Rights (echr.coe.int), 28.6.2012.
50. *Cha'are Shalom VeTsedek v. France*, 27417/95, European Court of Human Rights (echr.coe.int), 28.6.2012.
51. *Feti Demirtas v. Turkey*, 5260/07, European Court of Human Rights (echr.coe.int), 28.6.2012.
52. *Lautsi v. Italy*, App. No. 30814/06, 2011, European Court of Human Rights (echr.coe.int), 28.6.2012.

## BIOGRAFIA E AUTORIT

Dr. Aleksandar Spasenovski është lindur më vitin 1980. Ai është docent në Fakultetin juridik "Justiniani i parë", pranë Universitetit "Shënk Kirili dhe Metodij" në Shkup, Republika e Maqedonisë. Spasenovski ka doktoruar në vitin 2014 në temën që ka të bëjë me statusin kushtetues-juridik të religjioneve dhe të lirive të besimit fetar. Spasenovski tri herë është zgjedhur deputet në Parlamentin maqedonas, ndërkaq ka qenë edhe bursist i Fondacionit "Konrad Adenauer".

### **Vërejtje:**

**Qëndrimet e paraqitura në këtë publikim nuk janë qëndrime të Fondacionit Konrad Adenauer, por pikëpamje personale të autorit.**

### **Botues:**

Fondacioni Konrad Adenauer, përfaqësia në Republikën e Maqedonisë

### **Koordinim:**

Davor Pashoski

### **Përkthimi në shqip:**

Blerina Starova Zllatku

### **Dizajni dhe shtypi:**

Vinsent Grafika

Publikimi mund të shkarkohet falas në:

[www.kas.de/mazedonien](http://www.kas.de/mazedonien)



**Konrad  
Adenauer  
Stiftung**

### **Fondacioni Konrad Adenauer**

rr. "Maksim Gorki" 16 / kati i 3

tel: (02) 323 11 22

faks: (02) 313 52 90

e-mail: [skopje@kas.de](mailto:skopje@kas.de)

[www.kas.de/mazedonien](http://www.kas.de/mazedonien)